



**UNIVERSITETI I TETOVËS  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО  
UNIVERSITY OF TETOVA**

**PROGRAM**

**për punë të Rektorit të**

**Universitetit të Tetovës, për periudhën 2023-2026**

**Universiteti i Tetovës**

**Prof.dr. Myqereme Rusi**

**Tetovë, Qershori 2023**

## **HYRJE**

Universiteti i Tetovës është projekt i madh dhe më domethënës i shqiptarëve që jetojnë në R. e Maqedonisë së Veriut. Të udhëheqësh një institucion me një rëndësi jetike kërkon përgjegjësi dhe punë të palodhshme. Motivi im për tu kandiduar për Rektor të Universitetit të Tetovës bazohet në përvojën time shumëvjeçare në arsimin sipëror dhe në punën dhe kontributin time të dhënë në themelimin e këtij institucioni. Universiteti i Tetovës do të ketë një vizion të qartë dhe standarde strategjike, për të mbështetur zhvillimin e tij në traditën e cilësisë së lartë, por edhe në integrimin më të theksuar në hapsirën Evropiane të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor. Mbi këtë bazë, Universiteti i Tetovës do të vazhdojë të ruajë rolin e saj udhëheqës ndër universitetet shqiptare në vend, por në të njëjtën kohë do të përpinqet t'i arrijë universitet më të mira në botë. Drejtimi strategjik për zhvillimin e tij do të synojë përmirësimin e produktivitetit dhe përsosmërisë së kërkimit shkencor, si bazë për zhvillimin e cilësisë së lartë të arsimimit sipëror.

Si pjesë e këtij universiteti që nga themelimi e deri më sot jam më se koshiente për nevojat dhe kërkesat që do të paraqiten gjatë punës tre vjeçare si Rektor i këtij universiteti. Përvoja ime shumëvjeçare në universitet dhe në aktivitete të ndryshme shoqërore dhe kombëtare më jep besimin dhe kurajon e nevojshme që të udhëheq më një institucion si është Universiteti i Tetovës. Përvoja ime si Dekane e fakultetit Pedagogjik dhe Dekane e Fakultetit të Shkencave Humane janë dëshmi për aftësitë e mia menaxheriale.

Ka ndryshim në menaxhim nëse një universitet është universitet publik ose një universitet privat. As sfidat nuk janë të njëjta në varësi të faktit nëse universiteti është me pozita të mira financiare apo po lufton për stabilitet financiar. Drejtimi i një universiteti në një mësimdhënie është krijuar institucional dhe rregulator është i ndryshëm nga ai në një mësimdhënie ende në zhvillim.

Një kulturë akademike që thekson dhe motivon punën kërkimore ka prioritete dhe kufizime të tjera në krahasim me një traditë universitare që është kryesisht e orientuar drejt mësimdhënieve. Universiteti i Tetovës në të cilin konkuroj për postin e Rektor-it për momentin është i fokusuar dhe gjithë energjinë dhe potencialin e tyre

profesorët e kanë orientuar në mësimdhënie dhe shumë pak në hulumtime kërkuese dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sipas Steven C. Wheelwright, profesor emeritus i Universitetit të Harvardit, 95% e të qenit rektor i suksesshëm është të bërit mirë të gjërave normale. Gjërat normale janë ato që duhen bërë në çdo universitet, në çdo kohë dhe në çdo vend. Avancimi i këtyre gjërave normale çdo ditë e afrojnë universitetin më pranë qëllimeve të formulara në strategjinë e saj të përgjithshme. Për të qenë i shkëlqyer, një institucion akademik ka nevojë për një fakultet të shkëlqyer, një student të shkëlqyer, mësimdhënës të shkëlqyer dhe objekte të shkëlqyera.

Udhëheqja si rektor kërkon një aftësi specifike dhe shpesh të larmishme. Rektori duhet t'i përgjigjet prioriteteve konkurruese dhe të komunikon vendime të vështira në një mënyrë që ndërtzon besim dhe frymëzon fakultetet, stafin dhe studentët.

Misioni i Universitetit të Tetovës, synon t'u ofrojë studentëve të tij arsimim të lartë dhe njohuri të jashtëzakonshme, jo vetëm në aspektin e zhvillimit të tyre intelektual, por edhe në aspektin e zhvillimit të cilësive të tyre njerëzore dhe vlerave etike dhe të inkurajojë prirjen e tyre për t'u bërë liderë, duke shtyrë kufijtë e njohurive të tyre, promovimi i një mjeshtërisë intelektual në të cilin vlerat e vërteta vlerësohen dhe respektohen, një mjeshtëri në të cilin dallimet midis njerëzve respektohen dhe zhvillohen vlerat njerëzore. Me përkushtimin ndaj mësimdhënieve, kërkimit shkencor, aksesit të hapur në infrastrukturën kërkimore-shkencore, rritjes së produktivitetit të kërkimit shkencor, si dhe orientimit drejt progresit dhe prosperitetit, Universiteti i Tetovës do te bëhet lider në arsimin e lartë në vend, i cili do të vendosë standarde më të larta në arsimin e lartë, një universitet që vlerëson dhe inkurajon zhvillimin intelektual dhe personal dhe investon përpjekje të konsiderueshme për t'i shërbyer tërë shoqërisë.

Universiteti i Tetovës, do të jetë i hapur për çdo pjesëtar të komunitetit akademik dhe shërbim efikas të njësive të tij, të gatshëm për të pranuar iniciativat konstruktive dhe inovative të të gjithe punonjësve, për t'i mbështetur dhe zbatuar, sepse zhvillimi dhe prosperiteti i çdo njësie dhe çdo anëtarit të komunitetit akademik të UT-së është suksesi ynë i përbashkët. Synimi im kryesor do të jetë Universitet i hapur, sepse vetëm në këtë mënyrë ne mund t'i konkurojmë universiteteve të tjera në vend dhe më gjërë.

Si pikënisje kryesore të programës sime kam zhvillimin e Universitetit të Tetovës dhe ritjen e këtij universiteti në përputhje me trendet Botërore dhe kërkosat e tregut, duke qenë në përputhje me strategjitet për zhvillim të Universitetit të Tetovës.

Programa ime bazohet në nevojat e profesorëve, studentëve, në kërkesat e kohës për inovacion dhe ndryshim, kështu që ky program përfshin pika që janë reale për realizim dhe të domosdoshme për zhvillimin e universitetit dhe konkurrimin e këtij institucioni në vend dhe jashtë vendit. Gjithashtu do të merren parasysh edhe përfundimi me sukses i proekteve të cilet janë në zhvillim e sipër.

Në mandatin e ardhshëm do të vazhdoj të avokoj për një standard më të mirë për studentët dhe punonjësit e Universitetit. Do të inicoj procedura përrritje të pagave të punonjësve duke e forcuar pozitën e Sindikatës së Universitetit, si dhe fillimi i iniciativave të reja që do të kontribuojnë në një status më dinjitoz të të gjithë punonjësve të UT-së. Nga Ministria kompetente e Arsimit dhe Shkencës, do të kerkohen zgjidhje të reja sistemore, të cilat do të përmirësojnë standardin e studentëve, përfundimin e konviktit për studentët, përmirësimin e kushteve të mësimit, si dhe paga më të larta për punonjësit.

Përgjegjësia është edhe më e madhe, kur në kushtet e konkurrencës jolojale nga numri i madh i universiteteve në vend, modeleve joadekuante të financimit shtetëror, mbështetjes së pakët kombëtare për shkencën dhe të ardhurave të pamjaftueshme të stafit mësimdhënës dhe administrativo-profesional, duhet të tregojmë veten në arenën vendore dhe ndërkombëtare për të hyrë në listën e universiteteve më të mira, të cilat punojnë në kushte dukshëm më të mira se ne.

Shteti ndan finansa jo të mjaftueshme për zhvillimin e cilësisë së arsimit dhe shkencës, prandaj si prioritet i imi do të jetë iniciimi i proekteve të ndryshme ndërkombëtare përmes të cilave stafi akademik dhe studentët do të kenë mundësi zhvillimi, këmbimi të përvojave dhe fitimi i të ardhurave shtesë nga puna e tyre në projekte shkencore. Programi i punës dhe zhvillimit, përmes proekteve të përcaktuara, zbaton standardet evropiane, tashmë të miratuara në nivel kombëtar. Kështu, do të krijohen mekanizma të qëndrueshëm për ngritjen e cilësisë së arsimit dhe shkencës, si dhe do të rritet ndjeshëm bashkëpunimi dhe lëvizshmëria ndërkombëtare. Në mungesë të politikave kombëtare të qëndrueshme për financimin e shkencës, ato duhet të mundësojnë përfshirje më të madhe të stafit mësimor-shkencor dhe artistik në projektet e finançuara nga programet ndërkombëtare.

Ligji për arsimin e lartë mundëson që rolin drejtues të universitetit ta kenë mësimdhënësit dhe studentë, gjë që na jep mundësinë që bashkërisht të ndërtojmë dhe zbatojmë projekte zhvillimi. Nëpërmjet punës transparente dhe bashkëpunimit të koordinuar me të gjithë përbërësit social do të arrijë rezultate të larta. Në këtë mënyrë

do të forcojmë autonominë e universitetit në mjedisin social, por edhe autonominë e çdo mësimdhënësi për të krijuar dhe kontribuar me pikëpamjet e tij.

Duke u bazuar në përvojën time që nga themelimi i Universitetit të Tetovës e deri më sot besoj që kam kapacitet për të udhëhequr me këtë institucion. Nëse unë zgjidhem për Rektor të Universitetit të Tetovës do të punoj në mënyrë transparente që së bashku me gjithë stafin akademik dhe administrativ, me studentët ta zhvillojmë universitetin që të mund të jetë konkurent je vetëm në vend, por edhe në arenën ndërkombëtare.

## VIZIONI

Vizioni kryesor i paraparë në këtë program është që të gjithë së bashku, profesorë dhe studentë ta shndërrojmë UT-në në një universitet që ofron arsim evropian dhe arrin rezultate të larta në ved dhe jasht vendit, i gatshëm për të ndjekur trendet e ardhshme në arsim, shkencë dhe art. Duke u bazuar në konkurrencën ekzistuese qëllimi kryesor do të jetë përgaditja e kuadrove kualitative dhe konkurencës në çdo lëmi të tregut vendas.

## MISIONI

Universiteti i Tetovës do të aplikojë një model të përshtatshëm të qasjes moderne dhe multidisiplinare për edukim dhe transferim të njojurive si bazë për:

- Térheqjen e studentëve të rinj;
- Aplikimi i metodave të duhura sistematike të kërkimit dhe edukimit të kuadrove që do të punojë në tregun e punës, por edhe të kuadrove që do të vazhdojë me arsimim të mëtejshëm;

- Forcimi i kapaciteteve profesionale të stafit të profesorëve dhe bashkëpunëtorëve;
- Zhvillimi multidisiplinor dhe i përbashkët i programeve në fushën kërkimore dhe arsimore;
- Rritja e pjesëmarrjes së Universitetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në programe kërkimore, projekte, konsorciume dhe mënyra të tjera të bashkëpunimit;
- Përmirësimi i konkurrencës në nivel kombëtar dhe rajonal nëpërmjet transferimit të njohurive dhe shërbimeve;
- Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të informacionit dhe transparencës;
- Ngritja e vlerësimit të UT-së në listën e universiteteve më të mira vendore dhe botërore;
- Nxitja e autonomisë akademike dhe studentore;
- Funksionimi transparent dhe të përgjegjshëm;
- Dialog i vazhdueshëm me institucionet shtetërore për përmirësimin e çështjeve akademike dhe studentore.

### **Aktivitete në lidhje me procesin mësimor - shkencor**

- Motivimi i kuadrit mësimor për botim të teksteve mësimore që do të kontribojnë në përmirësimin e kualitetit të mësimdhënies;
- Nxitje të mobilitetit të mësimdhënësve;
- Të sigurohen laboratore për të gjitha programet studimore ku ka nevojë për mësim laboratorik;
- Organizim i programeve dhe mësimdhënies për mësim gjatë gjithë jetës;
- Organizim dhe përgaditje të programeve për seminare, trajnime, kualifikime të cilat kërkojnë tregun e punës;
- Nxitje e kualitetit të mësimdhënies duke e nxitur stafin akademik;
- Nxitje të sigurimit të kushteve për akreditim të programeve të reja studimore në të tre ciklet studimore;
- Nxitje të sigurimit të kushteve për akreditim të studimeve doktorale në të gjitha drejtimet studimore.

## **Aktivitete në lidhje me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimi e kushteve për të studiuar**

Studentët janë fokusi kryesor i arsimit të shekullit XXI në tërë botën. Ky trend duhet të reflektohet edhe në universitetin ton dhe t'i jepet më shumë rëndësi aftësimi dhe përgaditjes së kuadrove të reja të gatshme për tregun e punës. Funksioni parësor i arsimit të lartë është transferimi i njohurive akademike, zhvillimi i veprimtarive kërkimore dhe ngritja e kapaciteteve kërkimore. Sipas Deklaratës së Bolonjës, një nga komponentët kyç në përkufizimin e "cilësisë" së arsimit të lartë është "punësueshmëria". Vendosja e punësueshmërisë në fokus të arsimit të lartë nënkupton bashkimin e njohurive akademike, shkencës dhe përbajtjes të orientuar në sektorin real, prandaj theks më i madh duhet të vëndohet në të nxënët "aktiv" dhe vendosja e studentit në qendër të mësimdhënies dhe të nxënët. Duhet të jemi të sigurt që në përfundim të ciklit të arsimit të lartë, të diplomuarit të kenë kompetenca të përshtatshme për punësim, por edhe aftësi bazë, të cilat do t'u nevojiten gjatë gjithë zhvillimit të tyre të punës dhe karrierës. Përmirësimi i kapaciteteve të punësueshmërisë, me theks në njohuritë dhe aftësitë praktike, është në thelb një kombinim i njohurive akademike që është baza e të gjitha kompetencave kyçe të këruara nga tregu i punës, por edhe e njohurive dhe aftësive të tjera të sjelljes dhe praktike.

Që të mund studentët tanë të konkurojnë në tregun e punës dhe të zgjidhen në mes kandidatëve të diplomuar në universitetet tjera në vend duhet të plotësohen disa kritere:

- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, me të cilin Universiteti do të krijojë profesionistë aktivë, kreativë, kompetentë, konkurrues dhe të përgjegjshëm, të cilët do të mund të kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë në tërësi;
- Përmirësimi i kushteve materiale për mësim dhe punë në fakultete;
- Përfshirja e studentëve në aktivitete kërkimore, kulturore, sportive dhe të tjera dhe
- Lehtësimi dhe inkurajimi i zhvillimit të tyre në karriere
- Studentët dhe mësimdhënësit janë pjesë e pandashme e një tërësie, prandaj përmirësimi i procesit mësimor dhe zhvillimi i studentëve janë të lidhur në një tërësi. Për të arritur me cilësi më të mirë në mësimdhënie, nevojitet modernizimi, vlerësimi dhe përmirësimi i programeve të mësimdhënies dhe futja e metodave të reja moderne në mësimdhënie. Mund të përfshihet një proces të personalizuar mësimdhënieje dhe

punë mentorimi në disiplina të caktuara shkencore dhe artistike, dhe ndonjëherë edhe futjen e elementeve të mësimdhënies on-line, përfshirja e studentëve në në mënyrë interaktive në mësimdhënie dhe të theksohet mësimdhënia praktike. Është e nevojshme që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat akademike (për të shkruar, punë ekipore, prezantim, etj.). Për më tepër, Universiteti duhet të avokojë për nevojat e tjera të studentëve dhe mirëqenien e tyre personale (shëndetësore, psikologjike, familjare) dhe brenda mundësive të tij të kontriboj në përmirësimin e standardit të studentëve, sepse zhvillimi personal dhe profesional janë dy faktorët kyç për një cilësi më të lartë të jetës.

- Inovacioni dhe përmirësimi i kurrikulave në drejtim të përshtatjes së tyre me arritjet më të fundit shkencore dhe nevojat e tregut të punës;
- Inkurajimi i stafit mësimdhënës për të futur qasje moderne në mësimdhënie dhe mësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të kompetencave pedagogjike;
- Inkurajimi i internacionalizimit të programeve të studimit dhe angazhimi për rritjen e numrit të programeve të bazuara në diplomë të dyfishtë dhe diplomë të përbashkët me universitetet e huaja;
- Rritja e numrit të programeve të studimit që do të ofrohen në gjuhën angleze dhe tërheqja e një numri më të madh studentësh të huaj.
- Të jepet mbështetje financiare për pjesëmarrjen e studentëve tanë në gara të njohura ndërkombëtare;
- Promovimi i veçantisë së procesit mësimor të fakulteteve të artit;
- Avancimi i njohurive praktike dhe aplikative të studentëve dhe identifikimi i mundësive për të përmirësuar efektivitetin dhe rëndësinë e mësimdhënies dhe të nxënít.

### **Aktivitete që lidhen me punën kërkimore-shkencore të universitetit dhe puna me projekte.**

Dekadat e fundit jemi dëshmitar për rëndësinë e botimeve ndërkombëtare dhe avancimit të veprimtarisë kërkimore - shkencore. Në bazë të veprimtarisë kërkimore - shkencore bëhet edhe rangimi i universitetetve që është një kriter i cili duhet të

motivohet dhe të inicohet në mënyrë më intenzyive. Veprimitaria shkencore-kërkimore dhe artistike e Universitetit është me interes të veçantë sepse është themeli i arsimit modern universitar, është një pikë referimi kyç ndërkombëtar për vlerësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe konkurrencës së tij.

Në periudhën e ardhshme, është e nevojshme që Universiteti të përpinqet të zbatojë vlerat e përbashkëta dhe parimet për kërkim dhe zhvillim, të vendosur si synim përvendet e Bashkimit Evropian, në mënyrë që të zhvillohen sisteme të bazuara në korniza të përbashkët [3] (Pact for Research and Innovation in Europe, 2021) i cili bazohet në:

- Respektimi i vlerave të etikës dhe integritetit të kërkimit dhe zhvillimit, pavarësisë së kërkimit shkencor, si dhe mundësive të barabarta për të gjithë;
- Përmirësimi i kushteve për lëvizshmërinë e personelit kërkimor duke kontribuar në qarkullimin e studiuesve në të gjithë BE-në, duke nxitur shkëmbimet midis akademisë dhe industrisë, përhapjen e inovacionit dhe shkëmbimin e njojurive shkencore, të dhënave dhe mjeteve duke mbështetur akses të hapur në infrastrukturat kërkimore, infrastrukturat teknologjike dhe shërbimet e tyre;
- Ndjekja e përsosmërisë nëpërmjet një angazhimi për të mbështetur dhe shpërblyer në fushën e kërkimit të cilësisë më të lartë të mundshme, si një parakusht për ndikim më të madh shkencore, teknologjike, ekonomike dhe sociale dhe zgjerimin e bazës së njojurive të Evropës;
- Krijimi i vlerës, ndikimit social dhe ekonomik nëpërmjet: inkurajimit të bashkëpunimit multidisiplinair dhe ndërdisiplinor, investimit në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, aksesit në infrastrukturat kërkimore dhe teknologjike, ndërveprimit me industrinë dhe palët e tjera të interesuara në shoqëri, promovimin e kërkimit dhe zgjerimin e bazës së njojurive.

Në mënyrë që puna kërkimore-shkencore e Universitetit të jetë në një nivel të lartë, është e nevojshme të zhvillohen programe të përbashkëta të kërkimit dhe edukimit. Për këtë do të hartohet plan i posaçëm vjetor për punën kërkimore të kuadrit të universitetit.

Rritja e pjesëmarrjes së Universitetit në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare do të lejojnë jo vetëm shkëmbimin e ideve dhe përvojat, por edhe forcimin dhe përmirësimin e konkurrencës kombëtare dhe në nivel rajonal nëpërmjet transferimit të njojurive dhe shërbimeve. Ky qëllim synohet të arrihet përmes motivimit dhe stimulimit të realizimit të projekteve Erasmus, këmbimit të profesorëve

dhe studentëve përmes projekteve Erasmus +, duke iu përgjigjur me projekte kërkimore konkurseve të donatorëve të ndryshëm të cilët janë të interesuar për përkrahjen dhe zhvillimin e shkencës dhe hulumtimit. Do të inicoj marrëveshje bashkëpunimi me universitete të cilët kanë programe të ngjajshme me programet studimore të universitetit tonë me të cilët do të mund të shkëmbimë përvaja dhe do të mund të bashkëpunojmë në projekte kërkimore-shkencore. Në kuadër të programës së punës time do të mundohem të riaktivizoj kontaktet për inicim të marrëveshjes ndëruniversitare me universitete të ndryshme në kuadër të cilëve mësimdhënësit tanë mund të shkojnë për t'i përcjellur përvojat e tyre dhe gjithashtu edhe ekspertët dhe mësimdhënësit nga universitetit tjera të vin për ligjerata në universitetin tonë.

Do të inicoj formimin e një ekipi për të shkruar projekte i cili ekip do t'u vjen në ndihmë profesorëve të cilët kanë ide për projekte dhe kanë vullnet për të punuar në realizimin e projekteve të ndryshme shkencore.

Organizimi i kongreseve shkencore tradicionale të Universitetit të Tetovës do të jetë njëra ndër prioritetet në fillim të realizimit të programës sime, të cilat kongrese do të mund të organizohet edhe në bashkëpunim edhe me më shumë universitete të tjera.

### **Aktivitete në lidhje me nxitjen e mësimdhënies dhe organizimin e mësimdhënies.**

Mësimdhënia si proces është edhe shkencë edhe art. Mësimdhënien e bën shkencë informatat të cilat ua përciellim studentëve në lidhje me lëndën studimore, kurse art mësimdhënien e bën mënyra e përcielljes së atyre njojurive dhe ky aspek është shumë i rëndësishëm në nxënien e suksesshme të njojurive. Metodat e suksesshme të mësimdhënies do të vazhdojnë të aplikohen gjatë mësimdhënies dhe do të futen metoda të reja ndërvepruese në mësimdhënie në mënyrë që studentët të mund të zotërojëmë mirë temat e parapara në syllabusin e caktuar i cili synohet të realizohet në çdo lëndë. Universiteti i Tetovës ka nevojë edhe për metoda të reja të mësimdhënies që synojnë ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve si që janë mësimi laboratorik që nuk ka rol vetëm në mësimdhënie por edhe qëllime kërkimore. Për këtë arsyre do të inicohet hapja e laboratoreve në secilin drejtim studimor sipas nevojës së fushës studimore. Trend botëror në metodat e reja të mësimdhënies është zhvillimi i të

menduarit kritik te studentët. Për këtë do të organizohen punëtori për stafin akademik të cilët do të jenë të interesuar për të mësuar metoda dhe teknika për zhvillim të të menduarit kritik te studentët e tyre në lëndët përkatëse.

Me evaluimin e cilësisë së procesit arsimor me anë të anketave, pyetësorve, do të monitorohen kërkesat dhe pikat e dobta në mësimdhënie dhe në këtë mënyrë do të tejkalojen problemet eventuale që mund të paraqiten në procesin arsimor dhe në të njëjtën kohë do të mundësohet përmirësimi i cilësisë së mësimdhënieve.

Përveç mësimit frontal, në mësimdhënie duhet të futet në masë më të madhe edhe mësimi në grup edhe ai individual në të cilin çdo student duhet të aktivizohet dhe t'i pranojë njojuritë akademike në mënyrë aktive. Çdo student duhet të përparojë me ritmin e vet në procesin mësimor dhe për vlerësimin e suksesit të tij të merren parasyshë të gjitha komponentët të parapara në syllabuset e lëndëve përkatëse të cilat duhet të jenë në përputhje me Konventën e Bolonjës.

Në të njëjtën kohë, duke gjetur fonde synoj që klasat të përshtaten sipas nevojave dhe metodave inovative të mësimdhënieve. Profesorët në klasa duhet të kenë mundësi të lidhen me internet dhe të jetë në gjendje të mbajnë edhe mësim të kombinuar po edhe të përdorin video të ndryshme dhe informata nga interneti gjatë mësimdhënieve.

Një fushë tjetër shumë e rëndësishme e angazhimit tim do të jetë krijimi i kushteve më të mira të mësimdhënieve në fakultete (me pajisje të sofistikuara laboratorike) dhe do t'i kushtoj vëmendje të veçantë ndërtimit të një bibliotekë universitare dhe furnizimit të bibliotekës me literaturën më të fundit në fushën të ndryshme shkencore.

Përmirësimi i mësimdhënieve është një element i rëndësishëm në përparimin e studentëve. Në Universitetin e Tetovës në shumicën e fakulteteve mësimdhënia është në formë të ligjeratave dhe ushtrimeve. Për përmirësim të cilësisë së mësimdhënieve këtë formë të mësimdhënieve duhet ta zgjerojmë duke realizuar edhe ushtrime laboratorike, ekskurzione, praktikim i profesionit në vende reale të punës me mentor. Kapacitetet akademike mund të forcohen edhe me pjesëmarrje aktive në seminare, konferanca dhe ngjarje të tjera shkencore.

Do të realizohet evaluim i brendshëm i mësimdhënësve me qëllim të motivimit dhe përmirësimit të kualitetit të mësimdhënieve. Kualiteti i mësimdhënieve dhe punës kërkimore - shkencore do të nxitet edhe me dhënen e shpërbërblimeve mësimdhënësve të cilët do të dalin më të suksesshmërm nga evaluimin e brendshëm të

fakulteteve poashtu edhe mësimdhënësve të cilët do të kenë numrin më të madh të botimeve nëpër konferenca dhe revista shkencoreme çka stimulohet promovimi i universitetit dhe fakulteteve.

Gjatë pandemisë ne mësuam dhe fituam shprehi dhe shkathtësi të reja të funksionimit si që ishte mësimi online,i cili, sipas mendimit tim duhet të vazhdojë të aplikohet nëse do të jetë në funksion të tërheqjes së studentëve, zhvillimit të politikave pozitive dhe motivuese të mësimdhënies dhe mundësimit të mobilitetit më të lehtë.

Në bazë të programës së dorëzuar si Rektor i Universitetit të Tetovës synoj që ky universitet të merr vendin e merituar në mes universiteteve më të mira të vendit, rajonit dhe më gjërë. Duke shfrytëzuar të gjitha burimet në dispozicion (mësimdhënësit, studentë, laboratorë, qendra, etj.) do të krijohet një mjedis pozitiv në të cilin studentët dhe mësimdhënësit janë në qendër. Universiteti si një mjedis akademik inovativ do të krijojë kushte për nxitjen e krijimtarisë dhe zhvillimin e inovacioneve.

Prof.dr. Myqereme Rusi

Tetovë, 7.06.2023